



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 527/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Ferit Osmani kryesues, Vlastimir Dimić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 16.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

I Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 4000 (katërmijë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në buxhetin e Republikës së Kosovës.

II Fatos Selimi, i lindur me 08.02.1974 me nr. identifikimi 1170860191, në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit me nr. 1911e/01, në shkollën fillore “Ismail Qemajli” Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), i ndalohet për 4 (katër) vite, të marrë pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së si kandidat dhe 6 (gjashtë) vite, si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor të mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, duke filluar nga plotfuqishmëria e këtij vendimi.

A r s e y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 13.12.2010, nga subjekti politik LVV, më të cilën pretendon se Fatos Selimi, në cilësinë e Kryesuesit të Vendvotimit me nr. 1911e/01, në shkollën fillore “Ismail Qemajli” në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik PDK, ka marrë fletëvotime nga jashtë duke i futur brenda të cilat kanë qenë të plotësuar. Personi në fjalë ka shoqëruar votuesit tek kabina e votimit me ç’rast ka bërë shkelje të nenit 178 të Kodit Penal të Kosovës.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur fotografi si dëshmi.

Sanksionimi për shkeljet e parimeve të këtij Kodi

Neni 8 paragrafi 1 i Rregullës Zgjedhore nr. 11/2009, parasheh;

Shkelja e njërit nga këto nene të kodit të Sjelljes, në rastet kur këto shkelje nuk kanë ndikuar në rezultatet e zgjedhjeve, konsiderohet shkelje administrative dhe e dënueshme me gjobë sikurse është përcaktuar nga PZAP-i.

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

120.1 c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Neni 120 paragrafi 3 pika (d) i LZP-së, parasheh se:

120.3 d) Ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk u kalon gjashtë (6) vite.

Duke vendosur për gjobën PZAP ka marrë si rrethanë rënduese se shkelja ka të bëjë me veprimet e ndaluara dhe thyerjen e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët. PZAP sa i përket ndalimit për pjesëmarrje si kandidat dhe si pjesë e stafit administrativ siç është theksuar në dispozitiv të këtij vendimi ka marrë se shkelja ka ndodhur nga personi që ka qenë në dijeni me rregullat dhe procedurat e votimit. Prandaj nga arsyet lartcekura e më qëllim të evitimit të shkeljeve të potencuar më lartë dhe në pajtim me dispozitat e lartcekura ligjore, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 527/2010 më datën 16.12.2010

